

Gjendja: 25 Mai 2016

## **Prezantimi i procedurës zvicerane për ekstradim**

### **(Neni 17 i Rregullores për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet penale)**

1. Kontratat e ekstradimit paraprijnë thelbësisht të drejtën kombëtare (traktat shteti dypalësh, konventa e ekstradimit evropian etj.) në veçanti Ligjit Federal për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet Penale nga data 20 Mars 1981. (IRSG; SR 351.1). Ata rregullojnë detyrimet e Shteteve Kontraktuese në çështjet e ekstradimit. Nëse, megjithatë, përveç kësaj, IRSG lejon dhënien e ndihmës juridike, ose nëse në rastin individual nuk ekziston traktat Shtetëror, atëherë zbatohet IRSG. Për procedurën e ekstradimit mbizotërojnë IRSG dhe Rregullorja për ndihmë të drejtësisë ndërkombëtare në çështjet penale (IRSV; SR 351,11). Dispozitat e tyre më të rëndësishme janë përmbledh në këtë udhëzim (në kllapa tregohet neni përkatës). Nëse dëshironi, do të merrni tekstin e plotë të Kontrates ndërkombëtare të aplikueshëm në rastin tuaj, si dhe nga IRSG dhe IRSV, veçanërisht në gjermanisht, frëngjisht ose italisht.

Zyra Federale e Drejtësisë (BJ) është autoriteti kompetent në çështjet e ekstradimit. Megjithatë, autoritetet kantonale janë të përfshira në ekzekutimin e procedurës së ekstradimit (neni 16 IRSG).

Të gjitha parashtresat dhe ankesat në kontekstin e procedurës së ekstradimit duhet të jenë në një gjuhë zyrtare zvicerane. (Gjermanisht, frëngjisht ose italisht).

2. Ju keni të drejtë të caktoni një avokat të zgjedhur për përfaqësimin tuaj (neni 21 IRSG).

Pagesa e këtij avokati varet nga ju. Nëse nuk jeni në gjendje ta bëni këtë, ju mund të dorëzoni një kërkesë në BJ për pagesën e tarifës. Një kërkesë e tillë mund të dorëzohet edhe nga avokati juaj. Për këtë qëllim, ju ose avokati juaj do të pajiset me një formë të përshtatshme. Nëse ju tashmë keni rënë dakord me një ekstradim i thjeshtuar sipas nenit 54 IRSG dhe për këtë keni shfrytëzuar shërbimet e një avokat mund të bëni kërkesë edhe pas pajtimit tuaj për ekstradimin e thjeshtuar. Kompensimi i avokatit ligjor rregullohet me ligj dhe kufizohet në aktet e nevojshme të përfaqësimit. Dhënia e një mbrojtës ligjore falas nga BJ aplikohet vetëm në procedurat para kësaj zyre. Në kontekstin e procedurave të apelimit janë përgjegjëse vetëm autoritetet e ankesave përkatëse. Duhet të theksohet gjithashtu që emërimi i një avokati zyrtar ligjor për çështje penale komunale ose federale nuk zbatohet dhe për procedurat e ekstradimit.

Në raste të jashtëzakonshme, kur personi i persekutuar shpërfill ose nuk është në gjendje ta bëjë këtë (paaftësia mendore ose fizike) për të emëruar një avokat, BJ mundet të caktojë një avokat nëse është e nevojshëm për të mbrojtur interesat e personit të persekutuar.

Nëse dëshironi ju mund të kontaktoni me përfaqësimin tuaj konsullor në Zvicër (neni 16 IRSV)

3. Në rastet e ekstradimit, paraburgimi konsiderohet si e zakonshme (neni 50 par. 3 dhe 51 të IRSG-së). Kushtet për një lirim të përkohshëm janë më të rreptë se ato për Paraburgim. Megjithatë, BJ-i urdhëron lirimin tuaj të menjëhershëm nëse kjo kërkesë formale për ekstradim nuk mbërrin brenda periudhës së paraparë në fushëveprimin të traktatit ndërkombëtar të zbatueshëm ose të IRSG-së.

Kundër urdhrorit të ekstradimit ose të gjitha vendimeve të tjera të BJ lidhur me burgimin për ekstradim mund të parashtrohet ankesë brenda 10 ditëve në Gjykatën Federale Penale (neni 48 par. 2 të IRSG-së, neni 28, par. 1, lit. e i aktit të gjykatës penale [SGG]). Për më tepër ju keni mundësi në çdo kohë për të paraqitur një kërkesë për lirim nga burgu në BJ (neni 50, par. 3 IRSG).

4. Kërkesa për ekstradim duhet të përshkruajë personin kundër të cilit drejtohet procedura sa më saktë dhe plotësisht të jetë e mundur. Duhet të shënohet edhe autoriteti kërkues, objekti dhe arsyeja e kërkesës si dhe emërtimi ligjor i veprës. Për më tepër, duhet dhënë një përshkrim i shkurtër i fakteve thelbësore të veprës penale në fjalë si dhe një kopje të neneve të aplikueshme jashtë vendit dhe origjinalin ose një kopje e vërtetuar zyrtarisht të dënimit të detyrueshëm ose të urdhër arrestit. (neni 28 dhe 41 e IRSG-së).
5. Ekstradimi zakonisht jepet nëse të paktën një prej veprave penale, për të cilat jeni i akuzuar janë të dënueshme dhe të ekstradueshme si në Zvicër ashtu edhe jashtë vendit.

Ekstradimi do të refuzohet nëse procedura jashtë vendit është në kundërshtim me parimet e Konventit Evropian për të Drejtat e Njeriut është në kundërshtim ose mbahet për t'ju ndjekur ose për t'ju ndëshkuar për shkak pikëpamjet tuaja politike, për shkak të lidhjes juaj me një grupë social të veçantë ose për arsye të racës, fesë ose përkatësisë etnike (neni 2 IRSG). Një arsye për refuzim gjithashtu ekziston nëse vepra penale për të cilën jeni i akuzuar ka një karakter politik, paraqet shkelje të detyrave ushtarake ose nëse duket se është drejtuar kundër mbrojtjes kombëtare ose forcën ushtarake e shtetit kërkues (neni 3 IRSG). Megjithatë, kërkesa e karakterit politik nuk mund të merret parasysh në raste të veçanta të caktuara (neni 3, par. 2 e IRSG-së). Përveç kësaj, një kërkesë nuk do të përmbushet nëse ju jeni liruar në Zvicër për të njëjtin vepër penale ose nëse për të njëjtin vepër penale jeni tashmë i dënuar dhe keni kryer dënimin tuaj.

Nëse nuk specifikohet ndryshe (shih paragrafin 1) mund të refuzohet ekstradimi nëse vepra i nënshtrohet juridiksionit zviceran (neni 35 dhe 36 IRSG), nëse afati i kufizimeve ka kaluar sipas ligjit zviceran (neni 5 IRSG) ose në qoftë se subjekt i procedurës është një akt që duket i fokusuar në shkurtimin e taksave fiskale ose nëse janë lënduar Rregullat e masave të politikës monetare, tregtare ose ekonomike (neni 3, par. 3 të IRSG-së). Megjithatë, në kushte të caktuara, ekstradimi për mashtrim tatimor mund të jepet (neni 3 par. 3 lit.b e IRSG-së). Nëse mund të provosh menjëherë dhe përfundimisht se nuk ishit në vendin e ngjarjes në kohën e krimit, ekstradimi mund të mohohet gjithashtu.

6. Nëse kundërshtoni ekstradimin tuaj, ju mund të jepni në protokoll arsyet tuaja gjatë intervistës tuaj për kërkesën zyrtare për ekstradim (neni 52 IRSG). Pyetjet për fajin dhe faktin nuk mund të provohen në procedurat e ekstradimit. Para se të përcakton vendimin BJ, do t'ju jepet gjithashtu një periudhë e arsyeshme për të dhënë mendimin tuaj me shkrim për këtë kërkesë (neni 55 IRSG). Përveç kësaj, BJ-ja ka mundësi të përdorë

asetet tuaja personale për të mbuluar shpenzimet e procedurës neni 62, par. 2 e IRSG-së).

7. Nëse pajtoheni me ekstradimin dhe shprehimisht heqni dorë nga ekzekutimi i procedurës së ekstradimit, BJ do të lejon ekstradimin tuaj të thjeshtuar (neni 54 IRSG). Nëse ky pëlqim jepet shumë shpejt pas arrestimit, BJ-ja mund, për arsye proporcionaliteti, të heqë dorë nga kërkesa për shpenzime.

8. BJ vendos për ekstradimin (neni 55, par. 1 e IRSG-së).

Gjykata Federale Penale vendos mbi karakterin politik të veprës penale për të cilën ju jeni akuzuar (neni 55, par. 2 e IRSG-së).

9. Kundër vendimin e BJ mund të apelohehet në Bordin e Apelimit të Gjykatës Federale Penale brenda 30 ditëve nga shpallja e saj (neni 25, par. 1 e IRSG-së).

Kundër vendimin e Gjykatës Federale të Krimeve mund të apelohehet vetëm nëse është "një rast veçanërisht i rëndësishëm" (neni 84 e Ligjit Federal nga data 17 Qërshor 2005 për Gjykatën Federale (Kodi e Gjykatës Federale, BGG)). Gjithashtu, BJ mund të ankohet kundër vendimit të Gjykatës Federale të Krimeve (neni 25, par. 3 e IRSG-së).

Ekstradimi mund të ekzekutohet nëse ju shprehimisht heqni dorë nga e drejta për të paraqitur një ankesë ose nuk njoftojnë BJ-in brenda pesë ditëve nga shpallja e një vendimi (të BJ-it ose të Gjykatës Penale Federale), i cili lejon ekstradimin, që ju dëshironi të bëni një ankesë kundër vendimin (neni 56, par. 1 e IRSG-së). Ekstradimi është gjithashtu i zbatueshëm nëse nuk arrini të përmbushni periudhën e ankeses prej 30 ditësh ose 10 ditësh.

10. Ekstradimi i nënshtrohet parimit të specialitetit. Kjo do të thotë që shteti kërkues mund t'ju arrestojë, t'ju ndjekë penalisht ose t'ju dënojë vetëm për ato akte për të cilat është kërkuar dhe është lejuar ekstradimi (neni 38, par. 1 e IRSG-së). Megjithatë, ju keni mundësinë të heqni dorë nga ky parim. Ai gjithashtu nuk zbatohet për veprimet që janë kryer pas ekstradimit tuaj. Ai gjithashtu do të anulohet nëse nuk e keni lënë territorin e shtetit kërkues 45 ditë pas lirimit tuaj të kushtëzuar ose përfundimtar, ose nëse ktheheni tek ai pas largimit nga shteti kërkues (neni 38, par. 2 e IRSG-së).

Ekstradimi mund të jepet edhe me kërkesën e mëvonshme për vepra të tjera që nuk mbulohehen nga kërkesa origjinale për ekstradim (neni 39 IRSG).